




(Hartuar sipas: VKM Nr. 912, date: 11.11.2015, "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore", Ligjit Nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtojca II, pika 10. Prodhime infrastrukture. d) Ndertim rruges, portesh dhe instalimesh per porte, duke perfshire dhe portet e peshkimit (projekte qe nuk perfshihen ne shtojcen I).

RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**MASAT INXHINIERIKE PER PARANDALIMIN E RRESHQITJES NE UNAZEN E RE NE POGRADEČ
ME ZHVILLUES: INSTITUTI I NDERTIMIT**

Adresa: Unaza e re, Pogradec



Hartoi Raportin Paraparak të VNM-së:
"GO GREEN STUDIO" Sh.p.k

RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Zhvillues: "INSTITUTI I NDERTIMIT"

Hartoi Raportin Paraprak të VNM-së: "GO GREEN STUDIO" Sh.p.k

PËRMBAJTJA

•	Hyrje	2
1.	INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR	3
a)	Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se	3
b)	Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional	4
c)	Kuadri Ligjor nderkombetar	5
2.	PERSHKRIMI I PROJEKTIT	7
a)	Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar edhe me fotografi;	8
b)	Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij;	16
c)	Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer;	17
c)	nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si: ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe per prodhimin e mbetjeve;	19
d)	Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara;	23
dh)	te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te;	23
e)	mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin;	24
ë)	masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis;	24
f)	ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille);	28

➤ HYRJE

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i pergjegjesisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

➤ INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

a. OBJEKTIVAT AFATSHKURTER TE VNM JANE

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efijence;
11. Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
12. Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- ❖ Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimitet e pakthyeshme te mjedisit;
- ❖ Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;
- ❖ Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit;

Pershkrim i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kruhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

b. PËRSHKRIM I LEGJISLACIONIT NË FUQI

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 'Per mbrojtjen e mjedisit', te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 'Per vleresimin e ndikimit ne mjedis', te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura"
5. Ligji nr.10 253, date 11.3.2010 "Per gjuetine"
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullisor te ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 'Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore';

15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"
20. VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve neburim"
21. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"
22. VKM nr.519, date 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
23. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kriterëve te administrimit te pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor"
25. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
26. VKM nr.897. date 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave teVecanta te Ruajtjes"
27. VKM nr. 532, date 05.10.2000 "Per miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin"
28. VKM nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare"
29. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
30. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise"
31. VKM nr 352, date 29.04.2015. "Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te".

c. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBETAR

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- ✚ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ✚ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës,Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit ne fushën e politikës së ujrave.
- ✚ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ✚ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- ✚ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ✚ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.

- ✚ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ✚ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- ✚ Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEE/CE 78/659 për cilesinë e ujerave të embla
- ✚ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “Masat inxhinierike per mbrojtjen nga rreshqitja ne unazen e re, Pogradec”, i sherben komunitetit te zones por jo vetem. Ne hartimin e projektit per mbrojtjen nga rreshqitja, fillimisht eshte studiuar zona me rreshqitje ne hyrje te Unazes se dhe nga ky studim kane dale disa shkaqe qe kane siell prishjen e ekuilibrit te shpatit te rruges. Keto shkaqe jane:

1. Rilievi shume i pjerret krijon mundesi per rreshqitje per shkak te peshes se materialeve shkembore te cilat kerkojne qe te rivendosin gjendjen e ekuilibrit natyror qe ka ekzistuar para fillimit te ndertimit te rruges;
2. Formacionet shkembore ne kete segment jane shkaterruar nga levizjet tektonike dhe jane tjetersuar nga fenomenet klimaterike. Prania e ndershtresave te argjilave, te cilat ne prani te agjenteve atmosferike dhe lageshtires mbufaten dhe krijojne carje ne shtresat e tjera (conglomerate, ranore, etj), ndikon ne prishjen e ekuilibrit te shpatit;
3. Prania e carjeve ne formacionet shkembore, ne drejtime te ndryshme, sidomos prania e carjeve terthore me shtresezim dhe renie ne drejtim te renies se shpatit, ndikojne negativisht ne qendrueshmerine e shpatit;
4. Fenomeni i erozionit nga ujerat superfaqesore, gjate reshjeve massive nga levizja e ujerave siperfaqesor, te cilet futen ne carjet e shkembinjve dhe gerryejne materialin mbushes, krijohen faqe te lira te blloqeve te shkembinjve te cilat bien ne drejtim te renies se relievit, ne trasene e rruges ne hyrje te qytetit te Pogradecit;
5. Prania e ujerave nentokesore, shterat e argjilave jane te papershkueshme nga uje ndersa ben qe shtresat e ranoreve, konglomerateve dhe depozitimet deluvialo-eluviale te pershkohen nga uje, per kete arsye ne kontaktin midis shtresave dalin burime. Ujerat ngopin masat e depozitimeve deluviale-eluviale dhe pjesen e perjashtuar te formacionit rrenesor. Si rezultat i ngopjes me uje shtresat humbasin cilesine e tyre dhe levizin ne drejtim te kuotave me te ulta;
6. Zhveshja nga bimesia gjithashtu ka ndikuar ne ndryshimin e kushteve te qendryeshmerise se shpatit.

Qellimi i punes se ketij studimi te detajuar per mbrojtjen nga rreshqitja te rruges Unaza e re e Pogradecit perfshin;



Fazen e vleresimit ku do te behen vleresime dhe analiza te situates skzistuese;



Faza e projektit konceptual qe perfshin vleresimin dhe krahasimin e opsioneve te identifikuara dhe te propozuara per zhvillimin e konceptit te projektit per mbrojtjen nga rreshqitja te ketij segmenti rrugor;



Studim i besueshmerise per opsionet pergjithesisht te rena dakort;

a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes bimore ku propozohet të ndërtohet projekti dhe fotografitë përkatëse.

Gjendja ekzistuese

Ne skarpaten që kufizon Unazen e qytetit të Pogradecit ka patur rreshqitje dhe të vazhdueshme. Rreshqitja me serioze ka ndodhur në datën 24.05.2018 dhe ka shkaktuar problem serioze duke bllokuar aksin rrugor në fjalë dhe qarkullimin në të. Nga studimi gjeologjik rezulton se fenomenet me të rëndësishme gjeologjike e gjeodinamike që vihen re në këto faze janë:

- Erozioni
- Tjetersimi
- Rreshqitja aktive
- Sizmitet

Fenomeni i erozionit

Është një proces gjeologjik ekzogjen shumë i përhapur në zonën që po studiohet. Erozioni shfaqet në forme sipërfaqesore dhe shkaktohet nga veprimtaria shkateruese e rreshjeve. Duke zbritur poshtë këto depozitime bëjnë që deluvionet të jenë me të trasha, pa shtresime të rregullta dhe shpesh në levizje, çka duhet të merret parasysh gjatë punimeve të ndërtimit.


Fenomeni i tjetersimit

Ky fenomen është shumë i zhvilluar në zonën që po studiohet dhe shkaktohet nga kombinimi i faktoreve të ndryshëm fiziko-kimik të alternuar me faktoret klimatike. Si pasoje e këtij procesi shkëmbi rrenjesor ndryshon gjendjen e tij duke ulur ndjeshëm parametrat fiziko-mekanike. Ky fenomen ka ndikuar negativisht në shkëmbinjtë konglomeratike të zonës, të cilët nuk mund të rezistojnë fenomenit të tjetersimit për shkak të moshës së tyre. Këta shkëmbinjtë janë me moshe pliocenike, relativisht shumë të re, me çimentim të dobët argjilo-ranoik dhe karakterizohen nga lidhje të dobëta kohezionale. Në shpat gjatë periudhës së rreshjeve të shiut krijohen perroska, të cilat shpëllajnë pjesën e tjetersuar të shkëmbit dhe transportojnë materialin drejt kuotave me të ulta.

Rreshqitja aktive

Fenomeni i rreshqitjes është një nga fenomenet që rrezikon me shumë zonën në studim. Shirat e stinës së dimrit dhe pranverës kanë ndikuar në humbjen e qëndrueshmërisë së shpatit. Uji i shiut formon perroska të cilat depertojnë në brendësi të shkëmbinjeve duke ulur ndjeshëm parametrat fiziko-mekanike të dherave dhe shkëmbinjeve. Perroskat shpëllajnë pjesën e tjetersuar të shkëmbit dhe transmetojnë materialin drejt kuotave me të ulta. Rreshqitja aktive në këto zone rrezikon edhe disa banesa e godina biznesesh. Disa nga shkaqet që kanë aktivizuar rreshqitjen dhe mund të shkaktojnë riaktivizimin e saj janë:

- Pjerresia e shpatit
- Prania e ujerave siperfaqesore te pasistemuara;
- Prania e ujerave nentokesore;
- Mungesa e bimesise;
- Mosha e re gjeologjike e shkembijeve, te cilet jane me çimentim te dobet argjilor dhe nen veprimin e argjenteve atmosferike jane transformuar ne rera e zhavorre;
- Termetet qe rane ne zonen e Pogradecit gjate vitit 2017 kane shkaktuar copetimin e masivit shkembor;



Pamje nga rreshqitja e shpatit

Sizmiteteti

Nga te dhenat e grumbulluara ne vite rezulton se zona e qytetit te Pogradecit eshte prekur vazhdimisht nga termite te fort ate vatres se Pogradecit, te gjeneruara nga gjatesorja Peshkopi-Korce. Qyteti i pogradecit ndodhet ne nje zone me aktivitet te larte sizmik dh ender vite eshte prekur nga termite te fort ate cilat kane shkaktuar deme serioze ne godina dhe njerez. Zonat e shpateve rreshqitese jane shume te prekura nga termetet.



Pamje e rruges ku do te behet nderhyrja

Pogradeci është një qytet që ndodhet në Shqipërinë juglindore, në bregun jugperendimor të liqenit të Ohrit. Pogradeci është kryeqendra e rrethit të Pogradecit dhe bën pjesë në qarkun e Korçës. Qyteti ka një sipërfaqe prej rreth 13 km² dhe ndodhet në bregun e liqenit të Ohrit. Pogradeci shtrihet 700 metra mbi nivelin e detit në një lugine, e cila rrethohet nga mallet në perendim dhe nga kodra të uleta në jug dhe lindje. Ai ka një popullsi prej 20.848 banorë dhe një dendësi të popullsisë prej 2962 banorë për km².

Kjo zonë bën pjesë në brezin të klimës mesdhetare para-malore dhe malore. Për këtë arsye, por, dhe për shkak të kushteve të favorshme tokësore, i gjithë territori është i veshur me bimësi të larmishme e cila përbëhet kryesisht nga shkurret mesdhetare dhe nga dushqet. Mbulesat bimore, në përgjithësi shtrihen ose përhapen në të gjitha pjesët e sipërfaqeve që i kanë shpëtuar fenomenit negativ të gërryerjes; në këto pjesë të sipërfaqes mbulesat e bimësisë janë të padëmtuara nga ndërhyrjet e njerëzve, pyjet ruajnë pamjen e virgjër natyrore, ndërsa shkurretat janë diku të dendura dhe diku të rralla, jo mjaft të larmishme për nga numri i llojeve pjesmarrës. Në fakt jo çdo dëmtim i shkatuar të mbulesa bimore e tokës duket se ka vetëm një faktor negativ - gërryerjen në thellësi ose shplarjen në sipërfaqe të tokave; një faktor tjetër që ka krijuar kushte dhe ka nxitur pasojën desertifikuese të terreneve kanë qenë kullotjet e mbingarkuara me dhi dhe prodhimi i druve të zjarrit në mënyrë të pakontrolluar nga komunitetet e fshatrave rrotull. Llojet kryesore që gjenden në pjesmarrjen e mbulesave të shkurretave mesdhetare përbëhen kryesisht nga: Shkoza e Zezë (*Carpinus orientalis*), Mretja (*Phyllorea media*), Cermedelli (*Cotinus coccygia*), Dëllënja e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Ilqja (*Quercus ilex*), Thana (*Cornus mas*), Shelgu i bardhë (*Salix alba*), Driza (*Paliurus spina-christi*), Xana (*Spartium junceum*), Bushi (*Buxus sempervirens*). Në këtë zonë, peizazhi natyror ka një vlerë të veçantë. Bimësia pyjore dhe relievi i japin asaj një pamje të veçantë; gjatë shpateve të maleve rrjedhin ujëra burimorë të cilët furnizojnë perrenjte e zonës. E gjithë zona ka një hapësirë të madhe peisazhistike e cila është pjesërisht e veshur me pyje të dendur, pjesërisht e gërryer dhe e shplarë nga reshtjet atmosferike; nga ana tjetër ujërat burimorë dhe relievi i bukur malor mbart vlera të veçanta atraktive jo vetëm për banorët e komuniteteve autoktonë por edhe për turistët e vendit ose ata të huaj që vijnë periodikisht në këtë trevë për të soditur dhe për të vëzhguar këto pamje të vecanta.



Gjurma e projektit për mbrojtjen nga rreshqitja të rrugës Unaza e Re Pogradec

Zona në të cilën ka ndodhur rreshqitja ndodhet në hyrje të Unazës së re të qytetit të Pogradecit në lagjen "Kala". Në lindje rreth 65 m larg saj ndodhet liqeni i Ohrit, zona në studim është pjesë perberëse e kodrës së lagjes "Kala". Relievi është fushorë-kodrinor, lartësia maksimale është maja e kodrës së lagjes "Kala" me kuotë 888m. Zona është pjesë e fushëgropës së Pogradecit, e cila zë pjesën jugore e jugperëndimore të gropës së Ohrit. Gropa e Oher-Pogradecit është pjesë në zinxhirin e gropave tektonike që ndërpresin terthor strukturat me të vjetra.

Informacion rreth bimesisë dhe zonave të mbrojtura të rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarët e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre. Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit "Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë" u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar "Mali i Dajtit" dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Gjeografia

Pogradeci ndodhet në juglindje të Republikës shqiptare, është kryeqendra e rrethit të Pogradecit dhe bënë pjesë në qarkun e Korçës. Qyteti ka një sipërfaqe prej 13 km² dhe shtrihet në bregun e liqenit të Ohrit. Pogradeci shtrihet 700 metra mbi nivelin e detit në një luginë, e cila rrethohet nga malet në perëndim dhe nga kodra të ulta në jug dhe në lindje.

Klima dhe cilësia e ajrit.

Klima është tipike mesdhetare. Saranda ka 270-300 ditë me diell në vit. Si cdo lloj tjetër klime tipike mesdhetare ajo karakterizohet nga vera e thatë dhe e nxehtë dhe dimri i butë e i lagësht. Temperaturat më të larta në verë janë 25-27° C dhe në dimër 0-2 gradë. Temperatura mesatare vjetore është 17- 18 gradë në dimër. Temperaturat e ujit janë mesatarisht 16.3 gradë në dimër dhe 24.2 gradë në verë. Sasia e reshjeve varion 1.600-1.800 mm shi në vit.

Te pergjithshme rreth Zones se Mbrojtur te Liqenit te Pogradecit (kategoria IV e mbrojtjes)

Shpallur me Vendimin e keshillit te Ministrave Nr. 80, datë 18.02.1999 "Për shpalljen Park Kombëtar të Prespës dhe peisazh i mbrojtur tokësor/ujor të Pogradecit". Pogradeci Ndodhet në Qarkun e Korçës dhe në rrethin e Pogradecit. Sipëfaqja aktuale është 27,323.00 ha. ZM ndërkufitare. Liqeni tektonik më i thellë i Ballkanit (290 m) dhe një nga më të rëndësishmit në Europë e më gjërë. Së bashku me liqejt e Prespës përbëjnë bërthamën më të rëndësishme të një Rezerve Biosfere. Prania e një numri të madh llojesh endemike parruazoresh (sidomos në moluske Gastropode) dhe rruazorësh (peshq), i japin liqenit vlera të trashëgimisë botërore. Një nga IBA më të rëndësishme për shpendët dimëronjës të ujit (mbi 46 000 shpendë) në vëndin tonë. Është zona me masivet më të mëdhenj të gështenjës në vënd. Një zonë e rëndësishme turistike dhe pushimi si dhe për zhvillimin e aktiviteteve tradicionale kulturore e artistike me vëndet fqinje.


Në një peizazh të mbrojtur zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, ku ndalohen: a) mbjellja e pyjeve monokulturë; b) neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve e pikave të caktuara; c) shpërndarja e kafshëve dhe e bimëve jovendase; ç) gjuetia me ushqime të helmua; d) ndërtimi i autostradave, i kanaleve lundruese dhe i zonave urbane; dh) lëvizja me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk zbatohet për automjetet dhe makineritë shtetërore, bujqësore e pyjore, të zjarrfikësve, autoambulancave, makinerive të shërbimeve veterinarë dhe atyre të menaxhimit të ujërave; e) organizimi i garave me automjete, motoçikleta e biçikleta. Veprimtaritë që ndryshojnë përdorimin e territorit, ndërtimet, përdorimi i kimikateve e pesticideve, trajtimi i ujërave të zeza në ferma, për zona më të mëdha se 2 ha dhe veprimtaritë e tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga pika 2 e këtij neni, mund të ushtrohen vetëm pasi të jenë pajisur me leje mjedisi dhe të miratohen në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Monumentet e Natyres te Rrethit Pogradec (sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti natyror	Nr.	Monumenti natyrore
1	Burimi i Drilonit	10	Kanioni i Llenges
2	Guri i Kamjes	11	Selvite e Kishes Pogradec
3	Mullaret e Gurte-Trebinje	12	Rrepet e Tushemishtit
4	Fragment i shkeputjes tektonike te grabenit te Ohrit (Pogradec)	13	Guret "nusja dhe dhendri" Senisht
5	Shpella e Memlishtit	14	Shpella e Najazmes (Tushemisht)
6	Shpella e Radokalit	15	Rrapi i Radokalit
7	Shpella e Baribadhes	16	Rrapi i Selces se Siperme
8	Shpella e Shen Marene	17	Lisi i Leshnices
9	Mani i Shen Marenës	18	Liqenet e Lukoves



Ne ortofoto tregohen zonat e mbrojtura ne afersi te prjektit dhe distancat qe ka projekti me keto zona






Tabela Nr. 1 Koordinatat e gjurmes se projektit sipas sistemit GAUSS GRUGER

Nr.	E	N
P.1	4470688.43	4530383.46
P.2	4470661.98	4530492.25
P.3	4470620.00	4530586.36
P.4	4470613.48	4530641.59

Tab.2. Kordinatat e gjurmes se projektit sipas sistemit KRGJSH

Nr.	E	N
P.1	554809.9	4530400.26
P.2	554781.9	4530505.96
P.3	554738.5	4530600.46
P.4	554733.6	4530655.76

b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e zënë nga projekti dhe ne afersi të tij.

Ne zonen e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të rendesishme të identifikuar. Burimet ujore të kësaj zone janë burimet dhe perrenjte e vegjël në shpatet e maleve. Burimi ujor më i afërt i zonës është Liqeni Pogradecit i cili ndodhet në pjesën më të afërt që ka projekti me të 26.4 m larg dhe në pjesën më të largët 73.91 m larg. Laguna apo zona Bregdetare ndodhen larg kësaj zone objekt vleresimi.



c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të perberësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e perberësve të mjedisit klasifikohet në:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujerave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky projekt do të kryhet në rrugë ekzistuese siç është Unaza e Re e Pogradecit (segmenti në lagjen "Kala" në të cilën nuk ka bimesë të lartë, nuk ka park natyror, nuk ka demtime të bimesës së zonës. Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit të murit mbrojtës të rrugës
- ❖ Në fazën e funksionimit të rrugës pas nderhyrjes

Rendesi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikime të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuara.

Ndikimet kryesore në mjedis nga ndertimi dhe funksionimi i këtij aktiviteti konsistojnë në vijat e mëposhtme si më poshtë:

- ❖ Emetimet në ajër dhe zhurmat
- ❖ Shkarkimet në ujë
- ❖ Ndikimi në tokë
- ❖ Ndikimi në florë/faunë
- ❖ Mbetjet e prodhuara
- ❖ Ndikime social-ekonomike
- ❖ Ndikim në cilësinë e jetës në qendrat e banuara
- ❖ Ndikim në rritjen e trafikut rrugor
- ❖ Ndikim në peizazhin e zonës
- ❖ Ndikim në ndryshimet klimatike

Ndikimet gjatë marrjes së masave inxhinierike për rreshqitjen në Unazën e Pogradecit:

Projekti parashikon:

- Mbrojtje me mur gabion;
- Mbrojtje me perde me palankola;
- Mbrojtje e shpatit me rrjete gabion dhe ankera;

Keto aktivitete shoqërohen me:

- punime prishje, germimi dhe ndertimi për marrjen e masave kundër rreshqitjes së këtij segmenti rruge në lagjen “Kala”;
- përdorim karburati, nga mjetet e transportit dhe makinerit e ndertimit;
- punime për rehabilitimin e sipërfaqes së zënë perkohësisht nga punimet;
- bllokim i perkohshëm apo prishje e qarkullimit të mjeteve dhe kembësoreve;
- zënë e perkohshme të pronës shtetërore, rrugëve gjatë fazës së ndertimit të këtyre masave.

Gjate fazes se ndertimit:

- ndikim i perkohshem ne cilesine e ajerit;
- peisazh;
- qarkullimin e banoreve e automjeteve per shkak te punimeve per marrjen e masave kunder rreshqitjes se rruges se Unazes Pogradec;

Gjate fazes se shfrytezimit:

- Ndikim te perhershëm pozitiv ne mjedisin fizik, per shkak se do te permiresohet rruga e unazes, Pogradec;
- Ndikim te perhershëm pozitiv ne mjedisin socio-ekonomik, per shkak se do te permiresohet zona;
- Rritja e vlerave turistike te zones per shkak te permiresimit te cilesise se ajerit dhe levizshmerise komode te automjeteve;
- Projekti nuk parashikon humbje toke pasi ai do te ushtrohet ne rrugen e ndertuar (Unaza e Pogradecit);

ç) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

1. Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te ndertimit, gazet e mjeteve te ndertimit dhe te transportit.
2. Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri. Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja ku ka ndodhur rreshqitja.
3. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit qe ka rreshqitur ne siperfaqen ku shtrihet rruga e Unazes Pogradec. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe frekuentojne zonen. Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve.

Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrocERIA me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri apo ne vendin ku do te kryhen punimet per masat inxhinierike qe do te merren ne kete segment rruge kunder rreshqitjes.

Vete zhvillimi i ketij aktiviteti eshte ne te mire te komunitetit dhe ne afersi te liqenit (parallel) te Pogradecit dhe ne nje zone te banuar sic eshte lagjia Kala ku cilesia e ajrit duhet te jete e larte dhe subjekti eshte i detyruar te plotesoje kushtet ligjore te mjedisit.

Shkarkime ne uje

Punimet per marrjen e masave kunder rreshqitjes se rruges ne Unazen e re Pogradec nuk do te shkaktojne prishje te regjimit te ujerave nentokesore te zones ku dhe do te kryhen punimet dhe ne sistemin e kullimit dhe drenazhimit. Ujerat qe do te shkarkohen nga germimet ne themel do te jene te se njejtës natyre me ate te kanaleve kulluese te zones, pak me shume te ngarkuara me llumra argjile per shkak te perberjes gjeologjike te zones. Ujerat nuk do te jene te ngarkuar nga emulsione hidrokarbure ose shkarkime te lendeve kimike te ndryshme. Ato nuk do te prishin cilesine e ujerave te kanaleve ekzistuese.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat jane nje ndikim i pashmangshem mbi mjedisin gjate ndertimit. Zhurma mund te kufizohet duke ndjekur praktikat e mire-administrimit (pajisje/makineri te kalibruara) qe nenkuptojne se punimet do te kryhen vetem gjate orarit te rregullt te turneve te punes. Pajisjet e ndertimit do te plotesojne te gjitha standartet e zbatueshme te Direktives se BE 2000/14/EC, e Majit 2000. Direktive zbatohet per prodhuesit e pajisjeve qe shkaktojne zhurme. Te gjitha pajisjet duhet te mirembahen ne gjendje te mire pune. Oraret e transportimit te materialeve te ndertimit ne rruget e daljes do te caktohen me kujdes ne menyre qe te menjahet cdo shqetesim i tyrafikut lokal.

Ndotja nga zhurmat mund te vije nga perdorimi i makinerive ne ambjentin e punes. Ne projektin tone te marre ne studim, zhurmat do te shkaktohen kryesisht nga puna gjate fazes se ndertimit e mjeteve te renda te punes, te krijuara do te jete ne perputhje me udhezimin e permendur me siper, dhe nuk do ta kaloje kete kufi.

Zhurma do te jete e perkohshme dhe nuk do te kete akumulim te saj nga receptori njeri. Paksa te ekspozuara nga keto zhurma do te jene punonjesit qe do te punojne ne ndertimin e ketyre masave si ne ndertimin e murit gabion, te perdes me palankola dhe ne mbrojtjen e shpatit me rrjete gabion dhe ankerat, per te cilet do te kerkohet zbatimi i masave te sigurimit teknik ne pune dhe midis te tjerash dhe perdorimi i kufjeve. Zana e banuar ndodhet larg vendit ku do te kryhen ndertimet.

Disa burime qe do te shkaktojne zhurma dhe vibrime jane te paraqitura ne menyre te permbledhur si me poshte:

- Si pasoje e punes se mjeteve te ngarkimit dhe te transportit te materialeve apo inerteve, ndikime nga zhurma do te shkaktohen nga mjetet e ndertimit sic mund te jene, vinci, buldozeri, ekskavatore, kamionat qe transportojne materialet e ndertimit etj.
- Te shkaktohet gjate ndertimit te masave kunder rreshqitjes se rruges se Unazes se re Pogradec do te ndikojne ne rritje te nivelit te ndotjes akustike, ky ndikim do te jete i perkohshem vetem gjate ndertimit te ketyre masave.
- Te shkaktohet nga prania e punonjesve, bisedat midis tyre kjo sidomos gjate oreve te nates.
- Te shkaktohet gjate kalimit te mjeteve te ndertimit te tonazhit te rende, te cilat do te shkaktojne edhe vibrime ne mjedisin aty prane.

Gjate ndertimit do te ndikohet vetem ne jeten e punonjesve te ndertimit si dhe ne mjedisin e banuar aty prane sheshit te ndertimit, por ndikimi do te jete ne nivele te ulta. Zhurma e krijuar nuk do te jete e ndryshme nga zhurma e pergjithshme e krijuar nga punimet e ndertimeve civile. Zhurma pritet te jete e moderuar por e perkohshme pasi kontraktuesit aplikojne teknologji me te fundit per kontrollin e uljeve te vibrimeve dhe zhurmave ne menyre te konsiderueshme pa rritje te

shpenzimeve operative. Matjet shkencore kane treguar nje ulje prej te pakten 35-40 % te nivelit te impaktit te vibrimeve.

Mbetjet e prodhuara

Prodhimi i mbetjeve pritet te kete ndikimin me te rendesishem mjedisor, punimet e parashikuara ne kuadrin e projektit do te prodhojne disa lloje mbetjesh. Ato jane klasifikuar sipas katalogut evropian te mbetjeve dhe listes se mbetjeve te rrezikshme meqenese Republika e Shqiperise po perafrohet legjislacionin me ate te BE-se. Ketu po paraqesim emrin e grupeve te mbetjeve te shenuar me numra si ne katalogun evropian te mbetjeve. Ne secilin grup, llojet e mbetjeve mund te shenohen me yll (*) i cili perfaqeson mbetjet e rrezikshme. Nen-grupi i sakte i mbetjeve me numrin e tij identifikues do te identifikohet ne vendodhje.

Llojet e grupeve kryesore te mbetjeve qe mund te priten ne zone mund te jene si me poshte por nuk perjashtohen mbetje te tjera:

13 mbetjet e vajrave dhe mbetjet e karburanteve te lengshme (sic jane vajrat hidraulike nga paisjet);

15 mbetjet e paketimeve absorbentet, lecatat per fshirje, materialet e filtrave dhe veshjet mbrojtese, te cilat nuk specifikohen ndryshe;

17 mbetjet e ndertimit dhe shembjeve (perfshire dheun e germuar nga vendet e ndotura);

20 mbetjet bashkiake (mbetjet familjare, dhe mbetje te ngjashme tregtare, industriale dhe institucionale) perfshire copat e mbledhura vecmas;

Mbetjet e rrezikshme priten ne sasi te vogla, ne ndertimet e reja ato do te perfshijene mbetje te ndryshme nga mbetjet e vajrave te paisjeve dhe makinerive. Keto mbetje nuk duhet te perzihen me mbetjet e ngurta, kontraktori eshte i detyruar te kete kontenier te vecante te etiketuar per keto lloje mbetjesh. Per mbetjet e rrezikshme, kontraktori duhet te ndjeke proceduren e ndarjes se mbetjeve te rrezikshme ne vend. Kontraktori duhet ti dorezoj mbetjet tek kompania e autorizuar per administrimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te plotesoje dokumentacionin shoqerues i cili duhet te mbahet si prove e praktikese se mire ne administrimin e mbetjeve. Eshte shume e rekomandueshme te ndahen llojet e ndryshme te mbetjeve (ambalazhet plastike dhe te qelqit), per te cilat ekzistojne sisteme te vecanta grumbullimi/riciklimi ne vend, nga ato mbetje qe jane te pareciklueshme dhe te dergohen ne pikat e perdhatatshme te grumbullimit se bashku me dokumentacionin shoqerues.

Mbetjet e pariciklueshme duhet te dergohen ne nje landfill te miratuar. Sheshi i ndertimit do te pastrohet dhe te gjitha hedhurinat dhe materialet e mbetjeve do te eliminohen ne perputhje me klauzolat e specifikuara ne preventivat. Djegia apo hedhja e paligjshme e mbeturinave eshte rreptesisht e ndaluar. Mbetjet Bashkiake dhe mbetjet tjera do te duhet te mbidhen ne konteniere te vecante per kete qellim dhe te largohen rregullisht.

Dheu i rrezuar gjate rreshqitjes qe ka ndodhur per shkak te perqendrimit te larte Cr dhe Ni duhet te hiqet dhe te depozitohet ne nje vend i cili do te miratohet se bashku me Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit dhe autoritetet e Njesise Administrative. Perpara largimit te dheut te rrezuar, sheshi duhet te vizitohet edhe nga konsulenti mjedisor i cili do te informoje organet kopetente ne lidhje me zgjedhjen, duke dhene nje justifikim te shkurter per vendin ku do te kryhen punimet.

Administrimi i mbetjeve gjate fazes se ndertimit te masave per te parandaluar rreshqitjen ne kete segment rrugor duhet te behet ne perputhje me kerkesat dhe rregullat e vendosura nga autoritetet lokale. Te synohet riperdorimi i mbetjeve te ngurta, por edhe kur kjo nuk eshte e mundur

depozitimi i tyre te behet me leje te institucioneve perkatese dhe ne vendin e caktuar per kete qellim.

Mbetje te ngurta qe prodhohen nga ndertimi i i marrjes se masave te mbrojtjes se rruges nga rreshqitja ne kete zone jane mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike (paleta druri), materiale inerte te prodhuara nga punimet ndertuese, si dhe dheu e mbetjet inerte qe do te largohen nga sheshi i ndertimit. Materialet te cilat jane te riperdorshme, mund t'ju jepen individeve te interesuar per punime ndertimi ne zonat periferike ose rehabilitim te lulishteve ose mbushje te tokave aty ku ka nevojë, pjesa e mbetjeve te pa perdorshme duhet te grumbullohen ne vendin e caktuar nga Njesia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes se Lejes se Zhvillimit nga autoritetet pergjegjese.

Keto mbetje duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore dhe firmen pastruese te territorit dhe ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar qe ne vendburim. Mbetjet inerte, apo edhe dheu i i rene gjate rreshqitjes se ndodhur ne kete aks rruge, materiale te ndertimit duhet te trajtohen ne menyre te veçante. Ne kete faze nuk kemi informacion per menyren e menaxhimit te mbetjeve inerte.

Depozitimi i mbetjeve inerte të bëhet ne venddepozitim në baze te udhezimeve te Bashkise POGRADEC dhe ne perputhje me VKM Nr.575, date 24.06.2015 "Per miratimin e kërkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte". Transporti i mbetjeve inerte të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me licensë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Operatorët duhet te jene te paisur me License III.2.B sipas shtojces nr.1 te ligjit nr 10448 date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" ose ne shesh depozitimet e perkoshme te percaktuara nga Bashkia Pogradec ne perputhje me VKM 229 date 23.04.2014" Per menyren e transferimit te mbetjeve jo te rezikshme", në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Sipas VKM Nr.99 date 18.02.2015 Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve te cilat parashikohen te krijohen jane :

20 Mbetje urbane (Mbetjet shtepiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale te ngjashme) perfshire fraksionet e mbledhura vecmas

20 01 fraksionet e ndara

20 01 01 leter karton

20 01 02 qelq

20 01 08 mbetje te biodegradueshme

20 01 39 plastike

20 02 mbetjet e kopshteve dhe parqeve

20 02 01 mbetje te biodegradueshme

17 09 04 materiale inerte te prodhuara nga punimet si dhe mbetje që përfshihen në kategorinë e KODIT 17 05 Dhera (duke përfshirë dhera të germuar nga toka të kontaminuara, gure dhe balta të tjera) dhe në kategorinë e tij:

Kodi 17 05 04: Dhera dhe gure, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03;

Kodi 17 05 08: Çakell, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07;

Kodi 17 09 04: Mbeteje të perziera nga ndertimi dhe të prishjeve;

Jemi në një zonë të ndjeshme dhe për çdo ndikim sado të vogël, subjekti duhet të zbatojë me rigorozitet kushtet e kësaj zone të ndjeshme, duke marrë në konsideratë dhe parimin “ndotësi paguan”.

d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara

Punimet ndertimore, mund të zgjasin për një periudhë 3-6 muaj. Kjo është koha normale që duhet për të përfunduar se ndertuari masat që do të merren kundër rreshqitjes në këtë segment rrugor në kushte normale. Kjo është e vlefshme në kushte teknike, juridike e klime normale, por në rast se do të hasen vështirësi gjatë punimeve mund të ketë edhe shtyrje të afatit. Si rrjedhojë edhe ndikimet e fazës ndertimore do të zgjasin për atë kohë sa zgjasin punimet për ndertimin e e masave kundër rreshqitjeve në segmentin e rrugës së Unazës së Re, Pogradec.

Përsa i përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit ato do të jenë prezente për atë kohë sa do të përdoret edhe projekti. Ndikimi në peisazh do të jetë i perkohshëm.

dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Ndikimi në mjedisin e zonës do të ketë efektet e tij në një distancë jo shumë të gjatë, me dhjetra ose qindra metra, pra në një distancë jo më të largët se 200-300 m. Ky ndikim do të jetë i perkohshëm dhe nuk është me veti akumuluese në mjedis. Nuk shkarkohen elemente të demshme për mjedisin, si në atë ujor, për ajrin, tokën dhe për biodiversitetin. Ndikimi në peisazh do të jetë i perkohshëm për fazën e ndertimit dhe i përhershëm nga ndertimi i murin gabion, nga përdja me palankola dhe nga mbrojtja e shpatit me rrjetë gabion dhe ankerë.

Nga analiza e bërë e të gjithë faktoreve me ndikim në mjedis, rezulton se nga aktiviteti i ndertimit të të masave që do të merren për mbrojtjen nga rreshtja të rrugës së Unazës së re Pogradec ndikimet nuk do të kenë shtrirje të mundshme hapësinore, por do të jenë të kufizuara brenda sheshit të ndertimit, pra brenda zonës që zhvillohet.

e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga rëndësia e aktivitetit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompensime

Sipërfaqja e lire e vendit të shndërrohet në një mjedis të gjelbert, të pastër dhe të sigurt ndaj erozionit.

Subjekti investitor, në këtë rast vete ndertuesi, duhet që pas përfundimit të ndertimit të masave për mbrojtjen nga rreshqitja të objektit dhe infrastruktures perkatese, të kryejë rehabilitimin e plote të sipërfaqeve të lira, si ato të prishura për efektet e rreshqitjes së ndodhur por edhe ato për ndertimin e masave që do të merren për rindertimi i segmentit rrugor që do të prishet gjatë fazës së ndertimit të projektit në fjalë dhe për sipërfaqet e gjelberta. Për këtë të konsultohen me specialistet perkatese. Mbjellja e bimëve në hapësirat boshë, krijon hije dhe kushte klimatike të përshtatshme për kalimtarët apo frekuentuesit e ambienteve përgjatë rrugëve dhe zonave ku do të kalojë gjurma e projektit.

Mundësia e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe kthimi i mjedisit në gjendjen e mëparshme. Pas përfundimit të punimeve ndertimore, do të bëhet pastrimi dhe largimi i mbetjeve inerte që mund të kenë ngelur, gjelberimi që është pjesë e projektit, por nuk mund të pretendojmë rikthim në gjendjen e mëparshme të vendit ku do të kryhen punimet për mbrojtjen e rrugës nga rreshqitja.

e) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori ose nënkontratuesit për zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblodhur si më poshtë:

Masat lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndertimit dhe funksionimit të projektit të marrjes së masave për eliminimin e rreshqitjes në rrugën e Unazës së re, Pogradec.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhenien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përben në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të ndërmerren nga investitori për ndertimin e projektit të që do të vijë në ndihmë rrugës kundër rreshqitjes. Në fazën fillestare të punimeve, do të kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitje për fillimin e punimeve siç janë rievimet e vendit etj.

Kërkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësive e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, tortuareve, zonave të gjelbëruara.

Masat mbrojtese dhe parandaluese qe rekomandohen gjate fazes se ndertimit

- Te behet rrethimi i zones se ndertimit ne te gjithe perimetrin e saj per te shmangur daljen e gjithfare mbeturinash inerte, per te bere nje plan organizimi sa me te mire te objektit dhe per te shmangur gjithashtu impaktin negativ qe krijojne punimet.
- Largimi i dherave qe do te dalin ka projekti si ato te rreshqitjes se ndodhur si ato te punimeve qe do te kryhen per eliminimin e rreshqitjeve, do te kryhet brenda nje kohe shume te shkurter nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje ne ambientin perreth. Largimi i tyre te behet naten duke marre masa per te mos ndotur rruget. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat qe transportohen dhe duke i lare gomat e makinave para se te dalin nga sheshi i ndertimit. Mbetjet urbane do te grumbullohen ne perfundim te objektit ne vende te caktuara nga Njesia e Qeverisjes Vendore.
- Vendorsja e rrjetave mbrojtese per minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve.
- Realizimi i infrastruktures se brendshme rrugore do te realizohet ne perputhje me studimin urbanistik te zones perkatese duke i lene vend edhe siperfaqes se gjelbert sipas projektit.
- Mbeturinat ne perfundim te ndertimit te murin gabion, te perdes me palankola dhe te mbrojtjes se shpatit me rrjete gabion dhe ankera do te grumbullohen, transportohen dhe depozitohen ne vendet dhe oraret e caktuara nga Njesia e Qeverisjes Vendore.
- Nderhyrjet ne rrjetin e infrastruktures do te kryhen me lejet e institucioneve perkatese sipas ligjeve ne fuqi.
- Ndertimi do te kryhet nen kontrollin e inspektoreve te mjedisit, per te matur ndotjet ne mjedis te cilat nuk do ti kalojne parametrat e lejuar.

Masat kryesore per mbrojtjen e cilesise se ajerit.

Me qellim qe shkarkimet ne ajer qe emeton veprimtaria ndertuese te jene vazhdimisht brenda normave te lejuara, subjektet ndertuese marrin keto masa:

- Te perdoren mbulesa te perkohshme dhe te lagen sipas nevojës sheshet e punimeve, nje deri ne dy here ne dite per te reduktuar clirimet e pluhurave;
- Per levizjen e materialve te perdoren konvejere te mbyllur;
- Te behet mirmbajtja e sheshit gjate kryerjes se aktivitetit;
- Te gjitha materialet e transportuara jashte sheshit te ndertimit te jene te lagura ne menyre te mjaftueshme ose te mbuluara mire;
- Te gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndertimit te murin gabion, perdes me palankola, rrjetes gabion dhe ankera, transportit te nderpriten gjate periudhave me ere te forte;
- Te kufizohet shpejtesia e levizjes se automjeteve deri ne 30 km/ore;
- Te ndalohet pergatitja dhe perpunimi i bitumeve ne temperatura te larta ne vendin ku do te ushtrohet aktiviteti, dhe te perdoren bitume qe kane shkalle te vogel clirimesh te ndotesve ne ajer;

Masat kryesore per ruajtjen e flores/faunes.

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara nuk do të ketë pasi sic e kemi përmendur edhe me siper projekti do të zhvillohet ne gjurmen ekzistuese te rruges se Unazes se re, Pogradec dhe rrugeve automobilistike dhe nuk do të ndikojë ne biomase. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth.

Masat kryesore per zvogëlimin e zhurmave do të përfshijnë:

- Te respektohen standartet per nivelet e zhurmave ne zonat urbane.
- Mirëmbajtje dhe funksionimin e duhur të makinerive të ndërtimit për të minimizuar burimin e zhurmës.

Masat kryesore per trajtimin e ujerave:

Ujerat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të masave që do të merren për të ardhur në ndihmë rruges se Unazes se re, Pogradec të zones janë ujera të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagës së vendit ku do të kalojë projekti, largës se gomave të automjeteve, funksionimit të projektit dhe ujerat e reshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndërtimit, në varesi edhe të reshjeve të shiut, mund të grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave dhe si rrjedhojë mund të jete i nevojshëm grumbullimi i këtyre ujerave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimeve, dhe pse pjesërisht ato filtojnë nentokë dhe në kunetat e ndërtuara me parë në këtë aks rrugor për grumbullimin e ujerave të shiut.

Në vijim paraqitet një listë kontrolli për Masat Zbutëse të këtij projekti :

	Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
1	Mjedisi Fizik Dherat	-Dëmtime të strukturës së rruges si pasojë e ndërtimit të masave që do të merren kundër rreshqitjes, trafikut të transportit, etj.	-Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për turistët dhe banorët e zones, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara -Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve -Projektimi i drenazheve dhe mjeteve të tjera të hedhjes së mbeturinave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor

Toka	-Efektet e gërmimeve por edhe e materialit që ka rreshqitur / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore -Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës përreth projektit -Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve -Transportimi/hedhja e materialeve në vende të aprovuara
Cilësia e Ajrit	-Pluhuri dhe tymrat gjatë ndërtimit	-Të kontrollohet pluhuri me ujë, të kontrollohen metodat e ndërtimit, afatet e punimeve, shpejtësia e automjeteve -Projektim i përshtatshëm, training në masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes
Mjedisi Akustik	-Zhurma nga punimet ndërtimore,	-Të përcaktohen afatet e punimeve për të minimizuar shqetësimet -Të përdoren metoda dhe paisje
Mjedisibilogjik		
Habitatet Natyrore	-Shqetësimi i habitateve natyrore nga ndërtimi p.sh. pluhuri, zhurma, hedhje e mbeturinave të patrajtuara, etj.	-Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave të punimit -Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër vendit të projektit
Fauna dhe Flora	-Shqetësimi i faunes nga zhurmat etj	-Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore -Mbrojtja e zonave të ndjeshme mjedisore brenda/afër projektit
Mjedisi Social		
Estetika dhe Terreni	-Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje bimësie, etj. -Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	-Zëvendësim i bimesise të dëmtuara, strukturave të kufijve, etj. dhe rigjellbërime të zonave të punimeve. -Kryerja me kujdes e mbylljes së pikave të punimeve dhe hedhjes së mbeturinave -Sistemi i territorit sipas projektit të zbatimit.
Shëndeti i Njerëzve	-Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore -Efekte mbi shëndetin dhe sëmundje nga mbeturinat e,	-Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë, të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentat e kontratës. -Të sigurohet informacion mbi masat

		rrëzimet nga zjarri etj.	zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nëvojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, -Projektim i sakte dhe training i përshtatshëm për masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë, etj. -Hedhje e kujdesshme e mbeturinave
--	--	---------------------------------	---

f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmim të mjedisit ndërkufitar.

Projekti nuk ndikon cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit.

Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin ndërkufitar.

Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

Çertifikata dhe licenca perkatëse nga QKB, të specialistit që ka hartuar raportin e VNM.

Ky raport u hartua nga Studio Mjedisore e licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Bashkangjitur materialit nënshkrimi, vula dhe licencat perkatëse.

Hartoi raportin paraprak të VNM:

“GO GREEN STUDIO”

SH.P.K

Administratori:

Ismet KURTI